



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1300/1 Prot.

Tiranë, më 30 . 09 . 2024

V E N D I M

Nr. 256 , datë 30 . 09 . 2024

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 196 Regj., datë 23.09.2024, të z. K. R, kundër Bashkisë Fier dhe Inspektoriatit Vendos të Mbrojtjes së Territorit/IVMT-së, pranë Bashkisë Fier, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “*aftësisë së kufizuar*”³ dhe “*moshës*”⁴.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Referuar ankesës së depozituar pranë KMD-së, tek shpjegimi i fakteve për diskriminimin e pretenduar, subjekti ankues, z. K. R, parashtron se:

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

³ Referuar dokumentacionit mjekësor të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, konstatohet se, KMCAP, ka vendosur se ai ka shkallë të plotë invaliditeti. (Nr. Dosjes së Invaliditetit 5565/2)

⁴ Ankuesi është i datëlindjes 1952.

“Unë i nënshkruari K. I. R, banues në Fier, po ngre shqetësimin tim pranë institucionit tuaj, duke qenë se nuk po gjej zgjidhje prej afro 3 muajsh.

Jam banor i lagjes “Apollonia” në Fier, prej 30 vitesh, një lagje në qendër të qytetit. Ankesa ime ka të bëjë me konfliktin e lindur me komshiun në pallatin përbri, i cili ka bërë një shtesë, por tubacionet prej gati 3 muajsh kanë pësuar dëmtime dhe çarje, gjë që sjell gjithë shkarkimin e ujërave të zeza dhe të bardha në hyrjen e pallatit ku jetoj.

Kjo gjë kërcënon seriozisht shëndetin e banorëve dhe jo vetëm. Nuk kalojmë dot nga era e keqe dhe fakti që na pikon në kokë. Për këtë problem i jam drejtuar rajonit nr. 4, dhe rreth muajit korrik 2024 kam depozituar edhe një ankesë pranë Bashkisë Fier, për të cilën nuk kam marrë asnjë përgjigje. Punonjës të Bashkisë kanë ardhur dhe kanë verifikuar situatën, dhe verbalisht më kanë thënë që nuk bëjnë dot gjë ata dhe të mos kërkoj më ndihmë, por t’i drejtohem Gjykatës për këtë problematikë.

Përse u dashka që unë të shpenzoj lekë nëpër gjyqe kur problemet dhe konfliktet që cenojnë bashkëjetesën në komunitet janë kompetencë e IVMT-së, pjesë e Bashkisë Fier. Për më tepër nuk kam as mundësi financiare dhe shëndetësore të endem nëpër gjykata. Ndaj, i lutem Komisionerit të marrë në konsideratë ankesën time duke nxitur institucionet të kryejnë detyrat që ju takojnë, sikurse ne si qytetarë të thjeshtë paguajmë taksat pa asnjë kundërshtim.

Të më sorollatin mua në moshën që kam dhe që trajtohem me KEMP, për problemet shëndetësore në zemër është një diskriminim dhe largim nga përgjegjësitë që ju takojnë me ligj.

Problemi që kam ngritur kërcënon higjenën dhe shëndetin e banorëve dhe nuk është kapriço imja dhe as jashtë kompetencave të Bashkisë Fier, për më tepër në një lagje që konsiderohet parku i Fierit.”

Në përfundim të ankesës së tij, subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi: *“Të nxitë Bashkinë të marrë masa për problematikën e ngritur prej tij, pa e diskriminuar atë”*

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Pas analizimit të parashtrimeve dhe dokumentaconit të depozituar nga z. R, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e LMD-së, bazuar në arsyetimin vijues:

Së pari, bazuar në deklaratimet e subjektit ankues, Komisioneri vëren se, problematika e ngritur lidhur me shkarkimin e ujërave të zeza dhe të bardha, ardhur si pasojë e dëmtimeve në tubacionet e një shtese banese nga një komshiu i tij, në hyrjen e pallatit ku ai jeton, prek jo vetëm ankuesin, por të gjithë banorët e pallatit.

Komisioneri vëren se, pavarësisht pretendimit të ankuesit për gjendjen problematike në të cilën ndodhet ai dhe banorët e pallatit, ajo është një situatë e cila është faktike dhe ekziston pavarësisht shkaktuar individual të pretenduar nga ankuesi (mosha dhe aftësia e kufizuar) dhe e pandikuar nga këto shkaqe; dhe se pretendimi i tij për: mosndërhyrjen e institucioneve përkatëse për përmirësimin e ndreqjen e situatës; nuk bën pjesë në kompetencat lëndore të KMD-së.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “*“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi*”.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Nga ana tjetër, Komisioneri vëren se, ankuesi kur citon shkaqet për të cilat pretendon diskriminimin nga ana e IVMT/Bashkia Fier dhe Bashkisë Fier, evidenton faktin se *ai nuk ka moshën dhe gjendjen shëndetësore të duhur për të ndjekur gjyqësisht këtë çështje*, pra, këto shkaqe ai i lidh me *pamundësinë* e tij dhe *pasojat* që i vijnë nga mosveprimi i këtyre dy instancave shtetërore dhe jo me faktin që ky mosveprim ka ardhur pikërisht për shkak se ai posedon këto cilësi apo shkaqe apo të jetë motivuar prej tyre.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkaqet sipërcituar, Komisioneri vlerëson se, vetëm fakti që një person posedon këto shkaqe, nuk mjafton për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për shkaqet e pretenduara, por jo vetëm, duhet të parashtrijë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun e mbrojtur, që në çështjen objekt shqyrtimi janë mosha e ankuesit dhe aftësia e kufizuar e tij.

Pala ankuese nuk parashtron fakte apo rrethana nga të cilat të mund të prezumohet se ka patur sjellje, veprime apo mosveprime të institucioneve përgjegjëse që të jenë motivuar nga këto dy shkaqe.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Komisioneri vlerëson se, ndodhemi përpara rastit, kur ankuesi ka pretenduar për paligjshmëri dhe mosveprim të IVMT/Bashkia Fier, pretendim i cili mund të jetë objekt i shqyrtimit gjyqësor, pasi ndodhemi në kushtet e një konflikti të mirëfilltë civil të ankuesit dhe banorëve të pallatit të tij, me institucionin e IVMT/Bashkia Fier, në këtë rast. Pretendimi për paligjshmëri të veprimeve apo mosveprimeve të IVMT/Bashkia Fier apo vetë Bashkisë Fier, nuk bën pjesë në kompetencat lëndore të KMD-së⁵.

Së dyti, lidhur me pretendimin se Bashkia Fier nuk i është përgjigjur ankesës së tij, depozituar në muajin korrik 2024, Komisioneri vlerëson se, referuar këtij momenti, mosveprimi institucional ka të bëjë me moszbatimin e shkeljen e dispozitave ligjore të ligjit nr. 119/2014 “*Për të Drejtën e Informimit*”, të ndryshuar, dhe kjo kërkesë nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të përcaktuara shprehimisht në dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Komisioneri vlerëson se, lidhur me pretendimin e ankuesit, se institucioni sipërcituar, nuk i është përgjigjur kërkesës së tij; autoriteti mbikëqyrës i pavarur për zbatimin e ligjit nr. 119/2014 “*Për të Drejtën e Informimit*”, të ndryshuar, është institucioni i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

⁵ Për analogji citojmë Vendimin nr. 65, datë 22.04.2021, dhe Vendimin nr. 223, datë 02.11.2023, të KMD-së.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, shqyrton kërkesat e personave, të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre të parashikuara në ligjin 119/2014 *“Për të Drejtën e Informimit”*, të ndryshuar.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, marrja në shqyrtim e pretendimit të ankuesit për moskthim përgjigje nga ana e Bashkisë Fier, nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj⁶.

Në nenin 33, pika 4/b, të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b)është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji...”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, shkronja “b”, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, dhe për rrjedhojë kërkimet e subjektit ankues për të shqyrtuar sa më sipër, nuk pranohen.

Për sa më sipër, subjekti ankues mund t’i drejtohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës së informimit

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i rekomandon subjektit ankues, që, për problematikën e tij, t’i drejtohet për ofrimin e ndihmës ligjore falas, Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore (QSHNJP) Fier, me adresë: Lagjia “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Këshilli i Qarkut, Kati i 1, Fier.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b, të ligjit nr.10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës me nr. 196 Regj., datë 23.09.2024, të subjektit ankues K. R, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.

⁶ Për analogji citojmë Vendimin nr. 231, datë 25.11.2021 të KMD-së, Vendimin nr. 256, datë 29.12.2021, të KMD-së, Vendimin nr. 167, datë 22.08.2022, të KMD-së.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA